



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 263 prot.

Tiranë më, 16.06.2023

V E N D I M

Nr. 4, datë 31.05.2023

PËR

**“MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË  
BASENIT UJOR ISHËM”**

Në mbështetje të shkronjës “d”, pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, të Kreut 3, të Shtojcës II, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin Paraprak të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për publikimin Planit, si dhe koordinimin me autoritetet përkatëse për zbatimin e masave të parashikuara për menaxhimin e basenit ujor.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për ndjekjen e procedurës për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm në Këshillin e Ministrave.

SHOIR

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

